

**VENDIM**  
**Nr.27, datë 14.6.2011**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

|                   |                                |
|-------------------|--------------------------------|
| Bashkim Dedja     | Kryetar i Gjykatës Kushtetuese |
| Vladimir Kristo   | Anëtar i “ “                   |
| Xhezair Zaganjori | Anëtar i “ “                   |
| Petrit Plloçi     | Anëtar i “ “                   |
| Sokol Sadushi     | Anëtar i “ “                   |
| Sokol Berberi     | Anëtar i “ “                   |
| Altina Xhoxhaj    | Anëtar e “ “                   |
| Vitore Tusha      | Anëtare e “ “                  |

me sekretare Blerina Çinari, në datat 27.4.2011 dhe 10.5.2011 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.15 Akti që i përket:

KËRKUES: Kujtim Qefalia, përfaqësuar nga avokatja Elira Kokona, me prokurë

SUBJEKT I INTERESUAR: Këshilli i Ministrave, përfaqësuar nga Marsida Xhaferllari, me autorizim

OBJEKTI: Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën dhe marrëveshjet ndërkombëtare, i vendimit nr.138, datë 1.3.2011 të Këshillit të Ministrave “Për shkarkimin nga detyra të kryetarit të komunës Dajt”;

Pezullimi i ekzekutimit të vendimit të Këshillit të Ministrave.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 5, 17, 42, 45, 109, 115, 122, 131/a të Kushtetutës; nenet 45, 49, 50 dhe 51 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizmin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”; neni 42 i ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”,

**GJYKATA KUSHTETUESE,**

pasi dëgjoi kërkuesin që në kërkesat paraprake hoqi dorë nga gjykimi i kërkesës dhe kërkoi pushimin e gjykimit të çështjes; përfaqësuesin e subjektit të interesuar Këshilli i Ministrave që kërkoi pushimin e gjykimit të çështjes,

**VËREN:**

Këshilli i Ministrave, me vendimin nr.138, datë 1.3.2011, ka vendosur shkarkimin nga detyra, për shkelje të rënda ligjore, të kryetarit të komunës Dajt, Kujtim Qefalia.

Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese në datën 15.3.2011 me kërkesë për shfuqizimin dhe pezullimin e vendimit të mësipërm të Këshillit të Ministrave (VKM) si në kundërshtim me Kushtetutën dhe Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), duke parashtruar në mënyrë të përmblëdhur:

- VKM-ja për shkarkimin është marrë në mungesë të një procedure transparente dhe bazohet në një ligj të paqartë. Neni 42/a i ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizmin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, që është baza ligjore e shkarkimit, e zgjeron fushën e parashikimeve të nenit 115 të Kushtetutës, duke përfshirë përveç shkeljeve të Kushtetutës dhe ligjit penal edhe “çdo shkelje të rëndë të ligjit të çdo lloji natyre”. Kjo krijon premisa për parregullsi në vendimmarrjen e Këshillit të Ministrave dhe arbitraritet të arsyeve të shkarkimit të organeve të qeverisjes vendore.

- Vendimi i shkarkimit është i paarsyetuar, pasi nuk jep asnjë arsye për shkaqet konkrete që çuan në shkarkimin e kryetarit të komunës Dajt.

- Shkeljet e prezumuara nga vendimi i Këshillit të Ministrave nuk përbëjnë “shkelje të rënda të ligjit”, pasi veprimet juridike të kallëzuara penalisht jo vetëm nuk kanë sjellë pasoja me karakter penal ndaj kërkuesit, por ato nuk krijojnë asnjë pasojë juridike në kushtet e parashikimeve përkatëse të Kodit Civil.

- Proporcionaliteti i masës së shkarkimit nga detyra të një të zgjedhuri vendor është në kundërshtim me Kushtetutën dhe KEDNJ-në.

Në seancën plenare të zhvilluar në Gjykatën Kushtetuese (Gjykata) në datën 10.5.2011 përfaqësuesja ligjore e kërkuesit, në prani dhe të këtij të fundit, paraqiti kërkesë me shkrim për heqjen dorë nga gjykimi dhe për pushimin e çështjes objekt shqyrtimi.

Subjekti i interesuar u shpreh dakord me kërkesën dhe kërkoi pushimin e gjykimit të çështjes.

Gjykata konstaton se ligji nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, në nenin 1, paragrafi i dytë, parashikon se “Për çështje që lidhen me procedura që nuk rregullohen nga ky ligj, Gjykata Kushtetuese merr parasysh edhe dispozitat ligjore që rregullojnë procedurat e tjera, duke marrë në konsideratë natyrën ligjore të çështjes”. Bazuar në këtë normë, Gjykata iu referua nenit 201 të Kodit të Procedurës Civile (KPC), i cili parashikon se “Paditësi në çdo fazë të gjykimit mund të heqë dorë nga gjykimi i padisë. Në këtë rast, gjykata vendos pushimin e gjykimit”.

Në kushtet e mësipërme, Gjykata vlerëson se plotësohen kriteret për pushimin e gjykimit të çështjes në bazë të dispozitës së sipërcituar të KPC-së.

#### PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, bazuar në nenin 1 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” dhe nenin 201 të KPC-së, njëzëri,

#### VENDOSI:

- Pushimin e gjykimit të çështjes.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Xhezair Zaganjori, Vladimir Kristo, Sokol Berberi, Sokol Sadushi, Petrit Pllloçi, Vitore Tusha, Altina Xhoxhaj